



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2645/ 11 prot.

Datë 18.11.2025

V E N D I M
Nr. 1702/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshmik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ARISA - KONFEKSION” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk” në procedurën e prokurimit

Ankimues:

Operatori ekonomik “ARISA - KONFEKSION” SHPK me NIPT J61828068L dhe adresë Rruga 5 Maji, Nd. 82, Hyrja 7, Tiranë.

BOE “MALBERTEX shpk” me NIPT K71821009N dhe adresë Tirane Tirane Tirane, TIRANE, SIRI KODRA BLL.MAGAZINAVE, Tiranë & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”.

Autoriteti Kontraktor:

ILLYRIAN GUARD SH.A. me adresë Rruga Ibrahim Rugova, Tiranë 1016

Subjekt i interesuar:

OE “Vojsava Zeneli” P.F., NUIS L12330004A, me adresë Bulevardi “Gjergj Fishta”, kulla nr. 2, kati i dytë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.06.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A..

II.2. Në datën 29.08.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 16.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Arisa Konfeksion Sh.p.k 132,345,000 lekë I skualifikuar
2. BOE “Univers Promotion” shpk-Malbertex sh.p.k 98,430,000 lekë I skualifikuar
3. Vojsava Zenelaj P.F. 138,720,000 lekë I kualifikuar

II.4. Në datën 23.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 55, datë 29.09.2025.

II.5. Në datën 25.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2645/2025 protokolli, datë 26.09.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5859 e operatorit ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, e cila figuron me statusin e pa paguar, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5.1. Në datën 25.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2645/1/2025 protokolli, datë 26.09.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5860 e operatorit ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, ku janë të njëjtat pretendime si në formular ankese me numër ankimi elektronik A/2025/5859, me statusin e paguar mandat pagesa, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5.2. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.

2645/2 prot., datë 26.09.2025 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 2645/1/2025 prot., datë 26.09.2025.

II.5.3. Operatori ekonomik, subjekt i interesuar “Vojsava Zenelaj” PF, me anë të shërbimit postar, ka dërguar Formular Argumentash, të protokolluar me nr. 2645/3 prot., datë 02.10.2025.

II.5.4. Operatori ekonomik, subjekt i interesuar “Vojsava Zenelaj” PF, me anë sistemit elektronik të ankesave online, përsëri ka dërguar Formular Argumentash, të protokolluar me nr. 2645/4 prot., datë 02.10.2025, më të njëjtat pretendime.

II.5.5. Nëpërmjet shkresës me nr. 187/95 prot., datë 06.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2645/5 prot., datë 08.10.2025 me shkresën përcjellëse, me objekt “*Dërgim Vendim*”, (Vendimi i KSHA me nr. 187/94 prot., datë 06.10.2025), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë.

II.5.6. Me shkresën me nr. 2645/6 prot., datë 22.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua subjektit privat “Extrabis” shpk, duke i kërkuar informacion mbi një dokument të lëshuar nga ky i fundit.

II.5.7. Me shkresën me nr. 2645/7 prot., datë 22.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu ditur të gjitha palëve, se për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.5.8. Me shkresën e datës 22.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2645/8 prot., datë 24.10.2025, subjekti privat “Extrabis” shpk ka kthye përgjigje.

II.6. Në datën 02.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2721/2025 protokoli, datë 02.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5882 e BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues.

II.6.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 2721/1 prot., datë 03.10.2025 lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 2721/2025 prot., datë 02.10.2025.

II.6.2. Operatori ekonomik, subjekt i interesuar “Vojsava Zenelaj” PF, me anë sistemit elektronik të ankesave online, ka dërguar Formular Argumentash, të protokolluar me nr. 2721/2 prot., datë 06.10.2025.

II.6.3. Operatori ekonomik, subjekt i interesuar “Vojsava Zenelaj” PF, me anë të shërbimit postar, përsëri ka dërguar Formular Argumentash, të protokolluar me nr. 2721/3 prot., datë 06.10.2025, më të njëjtat pretendime.

II.6.4. Operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” Shpk, me anë sistemit elektronik të ankesave online, ka dërguar Formular Argumentash, të protokolluar me nr. 2721/4 prot., datë 07.10.2025.

II.6.5. Nëpërmjet shkresës me nr. 187/98 prot., datë 08.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2721/5 prot., datë 10.10.2025 me objekt “Vendim”, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë.

II.6.6. Operatori ekonomik, “Malbertex” Shpk, me anë sistemit elektronik të ankesave online, ka dërguar në trajtë narrative argumenta, të protokolluar me nr. 2721/6 prot., datë 28.10.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Arisa Konfeksion” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “.....• *Ofertuesi skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.2 duke qënë se dokumenti i paraqitur nga ana e tyre Autorizimi i Prodhuesit Portëest, nuk është lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor. Gjithashtu ofertuesi “Arisa Confecions” skualifikohet pasi nuk përmbush pikën 2.3.2 “Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë nëse janë prodhues apo tregtues të autorizuar nga prodhuesit për artikujt objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar dhe të vërtetojë lidhjen midis tyre. Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor”*

-Me date 28.08.2025 me anë të emailit të paraqitur në adresën zyrtare të prokurimeve të institucionit Illyrian Guard sha, me subjekt “Tërheqje e autorizimit të distributorit” subjekti

“Extrabis” shpk është tërhequr nga dhënia e autorizimit subjektivit “Arisa Confecscion”. Mungesa e autorizimit të prodhuesit të lartpërmendur të lëshuar për ofertuesin Arisa e bën të pavlefshëm prodhimin e artikullit mushama shiu. Sa më sipër ofertuesi skualifikohet.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3/ “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.2. *Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë nëse janë prodhues apo tregtues të autorizuar nga prodhuesit për artikujt objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar dhe të vërtetojë lidhjen midis tyre. Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Deklaratë prodhuesi për Mallrat;
- Autorizim prodhuesi i Portwest Ltd lëshuar, për subjektin Extrabis Shpk;
- Autorizim nga distributori i autorizuar i subjektivit Extrabis Shpk, për subjektin “Arisa Konfeksion” SHPK;

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin

mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.8. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.2. *Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë nëse janë prodhues apo tregtues të autorizuar nga prodhuesit për artikujt objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar dhe të vërtetojë lidhjen midis tyre. Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të*

jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor. Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se, operatorët ekonomikë ofertues për artikujt objekt prokurimi, duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar. Gjithashtu, në rastin kur është paraqitur autorizim nga distributori i autorizuar, ky autorizim duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni konstaton se, vetë operatori ekonomik ankimues ka bërë një deklaratë ku ka cilësuar se, për disa prej artikujve objekt prokurimi është vetë prodhues, ndërsa për artikullin mushama shiu prodhues ka deklaruar „Portwest Ltd“, ndërsa për artikullin stemë krahu ka deklaruar prodhues „ZhangJiaGang RunCheng Clothes&Hats Decoration Co., Ltd“. Referur arsyes së skualifikimit, të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor dhe ka dokumentacioni i ngakuar në SPE në përmbushje të këtij kriteri, KPP konsaton se, nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, pra autorizimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk është lëshuar nga vetë prodhuesi “Portwest Ltd”, por nga kompania “Extrabis” Shpk, e cila rezulton të jetë një distributor i prodhuesit për gamën e produkteve të prodhuara nga prodhuesi “Portwest Ltd”, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Referuar hartimit të kriterit 2.3.2 të DT, në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ky dokumet duhet të përmbajë të dhëna të plota si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij dhe të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi i dokumentit, autorizimi i distributorit të autorizuar “Extrabis” Shpk, përmban të dhëna të plota si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij dhe është lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor. Pra, arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, nuk qëndron, pasi për autorizimin e prodhuesit nuk është kërkuar që të përmbajë të dhëna, pra autoriteti kontraktor i është refuzuar një kriteri të pa kërkuar. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimi i ankimuesit është bërë duke iu referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimit publik. Gjithashtu, referuar arsyes tjetër të skualifikimit, se *“Extrabis” shpk është tërhequr nga dhënia e autorizimit subjektivit “Arisa Confecion”*. Mungesa e autorizimit të prodhuesit të lartpërmendur të lëshuar për ofertuesin Arisa e bën të pavlefshëm prodhimin e artikullit mushama shiu”, KPP ka kryer një hetim shterues, duke iu drejtuar me shkresën me nr. 2645/6 prot., datë 22.10.2025, subjektivit privat “Extrabis” shpk, duke i kërkuar informacion mbi një dokument të lëshuar nga ky i fundit. Me shkresën e datës 22.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2645/8 prot., datë 24.10.2025, subjekti privat “Extrabis” shpk ka kthye përgjigje, duke konfirmuar se, shoqëria “Extrabis” shpk konfirmon të vlefshëm për këtë procedurë prokurimi, dhënien e autorizimit për subjektivin “Arisa-Konfeksion” Shpk. KPP gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për përmbushjen e kriterit më sipër, është i vlefshëm dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Sa më sipër, Komisioni

gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik ankimes e plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Arisa Konfeksion” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se”.... • *Oferuesi skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.8 duke qënë se dokumenti i paraqitur prej tij në pëmbushje të kësaj pike konkretisht për produktin Triko, Kapele, Xhakovento, Këmishë me mëngë të shkurtra, Këmishë me mëngë të gjata, Pantallona Taktike, dokumente të lëshuar nga ana e vetë oferuesit “Arisa Konfeksion shpk”, dokument i cili në vetevete nuk është Certifikatë përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën të përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3/ “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.8. *Operatorët ekonomikë për secilin nga artikujt e uniformës (referuar specifikeve teknike) duhet të vërtetojnë se artikujt përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti SSH/EN për veshjet/pajisjet mbrojtëse dhe janë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në rregulloren EU nr. 425/2016. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatën/at përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë*

Te gjithë standardet që lidhen me kategorinë e Uniformave taktike të policisë ose ruajtjes së objekteve sipas rregullores (EU EN) 2016/425 renditen si më poshtë:

Standardi	Emertimi	Aplikimi
EN ISO 13688	Veshjet mbrojtëse – Kërkesa të përgjithshme	Bazë e detyrueshme standardi për veshjet PPE
EN 343	Veshjet mbrojtëse – veshjet kundër shiut	Mushamate, xhaketa për mbrojtje nga shiu
Serite e ISO 105	EN Rezistenca ndaj ngjyres (në larje, ferkim, drite, etj.)	Emblema, spaleta, logo, ngjitesë, kodi i identifikimit, pelhura të ngjyrosura, etj.
EN 1149-5	Veshje mbrojtëse – elektrostatike	Vetite Veshje taktike në mjedise të vecanta e të rrezikshme
EN 13758-2	Veshjet me mbrojtje ndaj UV	Uniforma për mbajtje në ambiente të jashtme për sherbim
EN ISO 20743	Aktiviteti antibakterial tekstilëve	I Opsionale për vetite higjienike

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Deklaratë nga subjekti prodhues “Arisa Konfeksion” SHPK;

-Deklaratë Konformiteti nga prodhuesi për artikujt: kapele pambuku, kapele poliestër, këmbisha me nëgë të gjata, këmbishë me mëngë të shkurtra, pantallona taktike, triko, xhakovento;

-Test raport për artikujt: kapele pambuku, kapele poliestër, këmbisha me nëgë të gjata, këmbishë me mëngë të shkurtra, pantallona taktike, triko, xhakovento lëshuar nga Azolab Laboratuvar Hizmetleri A.S. me nr. Akreditimi AB-xxxx-T, i akredituara nga ilac-MRA dhe TurkAK;

-Eu-Type-Examination certificate lëshuar nga SATRA Technology për produktet e prodhuara nga prodhuesi;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të

lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.7. Vendim nr. 674, datë 10.11.2021 për Miratimin e Rregullit Teknik “Për pajisjet mbrojtëse personale (pmp) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, Ky vendim është përafruar pjesërisht me rregulloren (BE) 216/425, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 9 marsit 2016, “Për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP)”.

KREU II “DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË”

Neni 8 “Detyrimet e prodhuesit” në të cilin parashikohet se: 2. *Prodhuesi harton dokumentacionin teknik të parashikuar në shtojcën III (“dokumentacioni teknik”) dhe kryen ose kërkon kryerjen e procedurës së vlerësimit të konformitetit, parashikuar në nenin 19 të këtij Rregulli. Kur nëpërmjet procedurave të përshtatshme demonstron përputhshmëria e PMP-së me kërkesat thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit, parashikuar në nenin 15 të këtij Rregulli, dhe vendos/fikson markimin CE të konformitetit, parashikuar nga neni 16 i këtij Rregulli.*

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.2.9. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.8, duhet të paraqesin Certifikatën/at përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara, për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Referuar arsyes së

skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, se operatori ekonomik ankimues, në vetë cilësinë e tij si prodhues, të disa prej produkteve objekt prokurimi, dokumenti i lëshuar prej vetë operatorit ekonomik ankimues *“Arisa Konfeksion” SHPK, në vetvete nuk është certifikatë sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar*. Komisioni sqaron se, referuar edhe legjislacionit sektorial, konkretisht Vendimit nr. 674, datë 10.11.2021 për Miratimin e Rregullit Teknik *“Për pajisjet mbrojtëse personale (pmp) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”*. Ky rregull teknik ka për qëllim përcaktimin e kushteve për projektimin dhe prodhimin e pajisjeve mbrojtëse personale (referuar si “PMP”) të vendosura në treg, në mënyrë që të garantohet shëndeti i përdoruesve, si dhe lëvizja e lirë në treg. Ky vendim është përafshuar pjesërisht me rregulloren (BE) 216/425, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 9 marsit 2016, *“Për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP)”*. Dokumenti *“Certifikata sipas Direktivës 2016/425/EU”* ose e përditësuar (për pajisjet mbrojtëse personale), jepet për prodhuesin, i cili ka përgjegjësinë të sigurojë që produkti i tij përmbush kërkesat e sigurisë dhe që nuk rrezikojnë shëndetin, dhe ky produkt të ketë shënimin CE i cili tregon se ka kaluar të gjitha testet, është në përputhje me standardet e përcaktuara dhe është në përputhje me legjislacionin e BE. Markimi CE iu nënshtrohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore. Në nenin 19 të Vendimit nr. 674, datë 10.11.2021 për Miratimin e Rregullit Teknik *“Për pajisjet mbrojtëse personale (pmp) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”*., parashikohet se: *“Procedurat e vlerësimit të konformitetit, sipas kategorive të rrezikut, të parashikuara në shtojcën I, janë si më poshtë: a) Kategoria I: kontrolli i brendshëm i prodhimit (moduli A), sipas shtojcës IV bashkëlidhur këtij rregulli; Në përmbushje të këtij kritri, operatori ekonomik ankimues, ka dorëzuar për të gjitha produktet objekt prokurimi, Deklaratën e Konformitetit të prodhuesit për artijkut për të cilat është vetë prodhues, shoqëruar me test raport nga Azolab Laboratuvar Hizmetleri A.S. me nr. Akreditimi AB-xxxx-T, i akredituara nga ilac-MRA dhe TurkAK si dhe për artikullin “mushama shiu” ka dorëzuar dokuemntin “Eu-Type-Examination certificate” lëshuar nga “SATRA Technology” për produktet e prodhuara nga prodhuesi, të cilët vërtetojnë përputhshmërinë me kërkesave e Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuar, të cilat janë konfirmuar se pas ekzaminimit/testimit dhe certifikimit të shoqërisë (prodhuese), artikujt e prodhuar nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të mësipërm pika 2.3.8, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.*

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“Arisa Konfeksion” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se”.... • Oferuesi skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.9, duke qënë se dokumenti i paraqitur në sistemin elektronik të APPsë, skedë teknike e lëshuar nga prodhuesi Portëest për produktin Musha Shiu, ku distributori i cili ka paraqitur autorizimin e prodhuesit ka tërhequr Autorizimin e Prodhuesit të Portëest të lëshuar.....”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3/ “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.9. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin skeda teknike të tekstilit të përdorur për prodhimin e artikujve, të lëshuara nga prodhuesi i tekstilit dhe të pajisura me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- skedë teknike e lëshuar nga prodhuesi Portwest për produktin Musha Shiu
- Autorizimin e Prodhuesit të Portëest;
- Autorizim nga distributori i autorizuar i subjektit Extrabis Shpk, për subjektin “Arisa Konfeksion” SHPK;

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të

lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.3.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.3.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit 2.3.9 si dhe referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor, se *“skedë teknike e lëshuar nga prodhuesi Portwest për produktin “Musha Shiu”, ku distributori i cili ka paraqitur autorizimin e prodhuesit ka tërhequr Autorizimin e Prodhuesit të Portwest të lëshuar”*, nga hetimi shterues i kryer nga ana e Komisionit, të cituar më lartë në këtë vendim, pasi subjektit privat “Extrabis” shpk, i është kërkuar informacion mbi një dokument të lëshuar nga ky i fundit. Me shkresën e datës 22.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2645/8 prot., datë 24.10.2025, subjekti privat “Extrabis” shpk ka kthyer përgjigje, duke konfirmuar se, shoqëria “Extrabis” shpk konfirmon të vlefshëm për këtë procedurë prokurimi, dhënien e autorizimit për subjektin “Arisa-Konfeksion” Shpk. Pra në këto kushte, kur autorizimi i distributorit të autorizuar është i vlefshëm, rrjedhimisht edhe skeda teknike e tij, është e vlefshme në përmbushje të kriterit 2.3.9 të DT.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se *“...• BOE “Malbertex + Univers Promotion skualifikohet pasi në ofertë duhet të përcaktonte pjesen e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejnë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. Ndërkohë në dokumentin e shkarkuar nga sistemi elektronik i APP-së të emërtuar “Marveshje_bashkepunimi (1).pdf” nuk është*

përcaktuar asnjë nga pjesët e shërbimit, punës dhe furnizimit kjo në kundërshtim me nenin 88 të VKM-së 285 datë 29.12.2021. Gjithashtu në dokumentin e shkarkuar nga sistemi elektronik i APP-së të emërtuar “Marveshje_bashkepunimi (1).pdf” citohet se: , duke përcaktuar ndër të tjera edhe “prodhimin” kjo në kundërshtim me dokumentin “Deklarate” ku përcakton se: Sipas përmbajtjes së lartpërmendur asnjë nga anëtarët e bashkimit të operatorëve nuk do jenë prodhues të mallit objekt kontrate por thjeshtë tregtarë të mallit.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Kontratë për bashkim operatorë ekonomikë, lidhur ndërmjet shoqërisë “Malbertex” Shpk & “Univers Promotions” Shpk, ku - Operatori ekonomik UNIVERS PROMOTIONS shpk mer përsipër zbatimin e kontratës në masën 50% - Operatori ekonomik MALBERTEX shpk mer përsipër zbatimin e kontratës në masën 50% - Realizimi i objektit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi sipas ndarjeve të mësipërme duhet kryer duke përfshirë, financimin, porositjen, prodhimin, stampimin dhe të gjitha detajet e tjera.

-tabelë ku janë evidentuar sasitë në % që do të furnizojë secili anëtar i BOE.

III.4.3. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë. 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës. 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”

Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të

përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

III.4.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.5. Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 83, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezultoi, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar mes shoqërisë “Malbertex” SHPK dhe shoqërisë “Univers Promotions” SHPK përkatësisht ku - *Operatori ekonomik UNIVERS PROMOTIONS shpk mer përsipër zbatimin e kontratës në masën 50% - Operatori ekonomik MALBERTEX shpk mer përsipër zbatimin e kontratës në masën 50% - Realizimi i objektit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi sipas ndarjeve të mësipërme duhet kryer duke përfshirë, financimin, porositjen, prodhimin, stampimin dhe të gjitha detajet e tjera.* Dhe tabelë ku janë evidentuar sasitë në % që do të furnizojë secili anëtar i BOE. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjykuar, se në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, jemi përballë rastit ku autoriteti kontraktor, kriteret e përcaktuara, i konsideron si kusht për përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe këto

të fundit, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e BOE ankimes “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se”.... • *Bashkimi i Operatorëve ekonomike skualifikohet pasi anëtarë i BOE “Univers Promotion” shpk nuk përmbush pikën 1 (a) të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi formulari i përmbledhës i vetëdeklarimit nuk është mbushur në mënyrë të plotë duke mos dhënë informacionin e kërkuar, konkretisht ofertuesi nuk ka plotësuar, në lidhje me punëtorinë, duke mos përcaktuar emrin e punonjësit si dhe profilin e tij sipas marrëveshjes së bashkëpunimit duke krijuar paqartësi në përcaktimin e profilit të punonjësit që do të mbulojë gjatë ekzekutimit të kontratës.*

• *Bashkimi i Operatorëve ekonomike skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.4 duke qënë se në asnjë nga dokumentet e paraqitura nga ana e tyre (shtojcën 9) nuk është deklaruar se kush do jetë modelist dhe cili nga anëtarët e BOE do e përmbushë këtë pike.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.5.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3/ “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.4. *Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në funksion të përmbushjes me sukses të kontrates duhet të vërtetojnë se disponojnë personel të kualifikuar, si më poshtë :*

1.Të pakten një Inxhinier tekstil

2.Të pakten një Modelist

Për sa më sipër operatorët ekonomike duhet të paraqesin :

Për inxhinierin tekstil:

Kopje të diplomës

Kontratën e punës;

Kopje të librezës së punës;

Deklarimin e profilit të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

Listapagesat sipas formularit E-Sig 025/a për peridudhën e kërkuar

Për punonjësin Modelist:

Dokument që të vërtetojnë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikate), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licensuara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.

Kontratën e punës;

Kopje të librezës së punës;

Deklarimin e profilin të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

Listapagesat sipas formularit E-Sig 025/a për peridudhën e kërkuar

Personeli i kualifikuar duhet të jetë pjesë e përvijës së ofertuesit dhe për këtë OE duhet të dëshmojnë se kanë patur në listapagesat e shoqërisë për një periudhë jo më pak se tre muaj nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, specialistët e sipërcituar.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provës do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.5.2. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, “Malbertex” SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë me operatorin ekonomik “Univers promotions” SHPK në pikën B “Deklaratë” në seksionin “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” ka bërë deklaram, konkretisht kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
Arbër Ballabani		Ne përmbushje të kërkesave të veçanta për kualifikim, pika 2.3.4	2.3.4. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në funksion të përmbushjes me sukses të kontratës duhet të vërtetojnë se disponojnë personel të kualifikuar, si më poshtë : 1. Të paktën një Inxhinier tekstil

III.5.2.1. Ndërkohë referuar sistemit elektronik të prokurimit elektronik rezulton se janë ngarkuar në sistem në cilësinë e subjekteve mbështetës për operatorin ekonomik “Arbër Ballabani” përfundimisht nga subjekti “Malbertex” SHPK, dokumentet si më poshtë:

- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Arbër Ballabani” SHPK dhe deklarata e angazhimit të tij përmes së cilës deklaroi se si subjekt mbështetës i operatorit “Malbertex” SHPK për procedurën konkrete të prokurimit do ta mbështesë për kriterin 2.3.4 Ing. tekstili;
- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK ;
- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Univers Promotions” SHPK;
- Diplomë e ing. Tekstili;

-certifikatë lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, për Znj. M. C, si stiliste/modeliste veshjes;

III.5.3. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet; 1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.* 2. *Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.* 3. *Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.* 4. *Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.* 5. *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre; b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.* 6. *Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.* 7. *Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.* 8. *Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale*

të operatorit. 9. Për operatorët ekonomikë vendas, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme. 10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. 11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit European.”

III.5.4. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet: 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohej këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.5.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

III.5.6. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme. - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. 3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër. 4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës. 5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. 6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit. 7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”*

III.5.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit

ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.5.8. Referuar arsyes së skualifikimit të BOE ankimues, pretendimeve të tyre dhe materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ KPP konstaton se, ky i fundit ka paraqitur në sistem Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për secilin prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në dokumentet e ofertës të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik rezulton si subjektet mbështetës të operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK, operatori ekonomik “Arbër Ballabani PF”, për të cilin ka paraqitur në sistem, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit “Arbër Ballabani” PF dhe deklaratën e angazhimit të tij për të mbështetur subjektin “Malbertex” SHPK në procedurën konkrete të prokurimi për kriterin 2.3.4 /Ing. Tekstili, por edhe vetë operatori ekonomi “Malbertex” SHPK i cili do të mbështetet mbi kapacitetin e subjektit më sipër, në formularin përmbledhës të vetë deklarimit, pika B, seksioni “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” ka dhënë informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Fakti që operatori ekonomik “Malbertex” SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë me “Univers Promotions” SHPK, ka deklaruar në dokumentet e ofertës konkretisht në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit subjektet mbi kapacitetet e të cilëve do të mbështetet ka vepruar në bazë të rregullave të

prokurimit publik dhe me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. *Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.* 2. *Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.* 3. *Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.* 4. *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.* Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo shikohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik jo vetëm janë përcaktuar kriteret për mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera por duhet edhe të deklarohet kjo mbështetje në dokumentet e ofertës. Në procedurën objekt-shqyrtimi, operatori ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë me “Univers Promotions” SHPK duke qenë se ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në seksionin përkatës, subjektet në kapacitetet e të cilëve do të mbështetet, me qëllim që të verifikohet përputhja me deklaratimeve të kryera në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit provues që tregon subjektet mbështetëse dhe llojin e mbështetjes që ata do të ofronin sipas angazhimit të tyre ka vepruar konform dhe në zbatim të rregullave të prokurimit publik. Është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ato oferta që nuk përgatiten në përputhje me këtë kërkesë konsiderohen si të pa vlefshme. Gjithashtu, referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor se, pasi anëtar i BOE, konkretisht “Univers Promotions” Shpk nuk ka plotësuar në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit në lidhje me puntorinë, Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e BOE në përmbushje të kriterit 2.3.4 të DT, ku kërkohet një ing. Tekstili për të cilin BOE është mbështetur tek subjekti mbështetës “Arbër Ballabani” PF, i cili ka dorëzuar edhe diplomën përkatëse sipas profilit të kërkuar. Ndërsa për punonjësën e profilit një modelist/stilist veshjes, anëtar i BOE konkretisht “Malbertex” Shpk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit tek seksioni B “Deklaratë mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e puntorisë në umër dhe sipas profileve të kërkuara në pikën 2.3.4 të DT. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se me dokumentacionin e paraqitur duke deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit subjektet mbi kapacitetet e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “Malbertex” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: • *Bashkimi i Operatorëve ekonomike skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.2 duke qënë se dokumenti i paraqitur nga ana e tyre Autorizimi i Prodhuesit, nuk është lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3/ “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.2. *Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë nëse janë prodhues apo tregtues të autorizuar nga prodhuesit për artikujt objekt prokurimi.*

Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar dhe të vërtetojë lidhjen midis tyre.

Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor.

III.6.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Deklaratë e prodhuesit “KingLong Protective Products (HUBEI) Co., Ltd., për produktet objekt prokurimi;
- Deklaratë e distributorit të autorizuar “Malbertex” shpk me të dhënat e plota,
- Deklaratë e distributorit të autorizuar “Univers Promotions” shpk me të dhënat e plota,

III.6.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.6.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të

barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.6.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.6.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.6.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.6.8. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.2. *Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë nëse janë prodhues apo tregtues të autorizuar nga prodhuesit për artikujt objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim nga*

prodhuesi/distributori i autorizuar dhe të vërtetojë lidhjen midis tyre. Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor. Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se, operatorët ekonomikë ofertues për artikujt objekt prokurimi, duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar. Gjithashtu, në rastin kur është paraqitur autorizim nga distributori i autorizuar, ky autorizim duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.6.2. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni konstaton se, vetë operatori ekonomik ankimues ka bërë një deklaratë ku ka cilësuar se, për të gjithë artikujt objekt prokurimi nuk është vetë prodhues, por është i pajisur nga prodhuesi me autorizimin e kërkuar për këtë procedurë prokurimi. Referur arsyes së skualifikimit, të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor dhe ka dokumentacioni i ngakuar në SPE në përmbushje të këtij kriteri, KPP konsaton se, nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, pra autorizimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është lëshuar nga vetë prodhuesi “KingLong Protective Products (HUBEI) Co., Ltd”, për gamën e produkteve të prodhuara prej tij, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Referuar hartimit të kriterit 2.3.2 të DT, në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ky dokumet duhet të përmbajë të dhëna të plota si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij dhe të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor. Pra, arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, nuk qëndron, pasi për autorizimin e prodhuesit nuk është kërkuar që të përmbajë të dhëna, pra autoriteti kontraktor i është refruar një kriteri të pa kërkuar. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomik ofertues është bërë duke iu referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimit publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: • *Bashkimi i Operatorëve ekonomike skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.8 duke qënë se dokumenti i paraqitur prej tyre në përmbushje të kësaj pike, dokument i lëshuar nga ana e prodhuesit “KINGLONG PROTECTIVE PRODUCTS (HUBEI) CO., LTD”, dokument i cili në veteve nuk është Certifikatë përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën të përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.7.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3/ “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.8. *Operatorët ekonomikë për secilin nga artikujt e uniformës (referuar specifikeve teknike) duhet të vërtetojnë se artikujt përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti SSH/EN për veshjet/pajisjet mbrojtëse dhe janë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në rregulloren EU nr. 425/2016. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatën/at përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë*

Te gjithë standardet që lidhen me kategorinë e Uniformave taktike të policisë ose ruajtjes së objekteve sipas rregullores (EU EN) 2016/425 renditen si më poshtë:

Standardi	Emertimi	Aplikimi
EN ISO 13688	Veshjet mbrojtëse – Kërkesa të Baze e detyrueshme standardi për veshjet përgjithshme	PPE
EN 343	Veshjet mbrojtëse – veshjet kunder shiut	Mushamate, xhaketa për mbrojtje nga shiu
Serite e ISO 105	EN Rezistenca ndaj ngjyres (ne Emblema, spaleta, logo, ngjitesë, kodi i larje, ferkim, drite, etj.)	identifikimit, pelhura të ngjyroshme, etj.
EN 1149-5	Veshje mbrojtëse – Vetite elektrostatische	Veshje taktike në mjedise të vecanta e të rrezikshme
EN 13758-2	Veshjet me mbrojtje ndaj UV	Uniforma për mbajtje në ambiente të jashtme për shërbim
EN ISO 20743	Aktiviteti antibacterial tekstileve	I Opsionale për vetite higjienike

III.7.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Deklaratë konformiteti i prodhuesit “Kinglong Protective Products (HUBEI) Co., Ltd”,
- Certifikatat e cilësisë për të gjitha produktet objekt prokurimi lëshuar nga Eumak Kontrol (Quality superintendence corporation);
- Certifikata e akreditimit të Eumak Kontrol (Quality superintendence corporation), lëshuar nga Instituti për Akreditim RMV;

III.7.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.7.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.7.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve,

duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.7.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.7.7. Vendim nr. 674, datë 10.11.2021 për Miratimin e Rregullit Teknik “Për pajisjet mbrojtëse personale (pmp) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, Ky vendim është përafërsisht me rregulloren (BE) 216/425, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 9 marsit 2016, “Për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP)”.

KREU II “DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË”

Neni 8 “Detyrimet e prodhuesit” në të cilin parashikohet se: 2. *Prodhuesi harton dokumentacionin teknik të parashikuar në shtojcën III (“dokumentacioni teknik”) dhe kryen ose kërkon kryerjen e procedurës së vlerësimit të konformitetit, parashikuar në nenin 19 të këtij Rregulli. Kur nëpërmjet procedurave të përshtatshme demonstron përpunshmëria e PMP-së me kërkesat thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit, parashikuar në nenin 15 të këtij Rregulli, dhe vendos/fikson markimin CE të konformitetit, parashikuar nga neni 16 i këtij Rregulli.*

III.7.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të

paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.7.9. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.8, duhet të paraqesin Certifikatën/at përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara, për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.7.2. të këtij vendimi. Referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, se operatoi ekonomik ankimues, në vetë cilësinë e tij si distributor i autorizuar, të produkteve objekt prokurimi, dokumenti i lëshuar prej prodhuesit “Kinglong Protective Products (HUBEI) Co., Ltd”, *në vetvete nuk është certifikatë sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar*. Komisioni sqaron se, referuar edhe legjislacionit sektorial, konkretisht Vendimit nr. 674, datë 10.11.2021 për Miratimin e Rregullit Teknik “*Për pajisjet mbrojtëse personale (pmp) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara*”. Ky rregull teknik ka për qëllim përcaktimin e kushteve për projektimin dhe prodhimin e pajisjeve mbrojtëse personale (referuar si “PMP”) të vendosura në treg, në mënyrë që të garantohet shëndeti i përdoruesve, si dhe lëvizja e lirë në treg. Ky vendim është përafruar pjesërisht me rregulloren (BE) 216/425, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 9 marsit 2016, “Për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP)”. Dokumenti “Certifikata sipas Direktivës 2016/425/EU” ose e përditësuar (për pajisjet mbrojtëse personale), jepet për prodhuesin “Kinglong Protective Products (HUBEI) Co., Ltd”, i cili ka përgjegjësinë të sigurojë që produkti i tij përmbush kërkesat e sigurisë dhe që nuk rrezikojnë shëndetin, dhe ky produkt të ketë shënimin CE, i cili tregon se ka kaluar të gjitha testet, është në përputhje me standardet e përcaktuara dhe është në përputhje me legjislacionin e BE. Markimi CE iu nënshtrohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore. Në nenin 19 të Vendimit nr. 674, datë 10.11.2021 për Miratimin e Rregullit Teknik “*Për pajisjet mbrojtëse personale (pmp) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara*”, parashikohet se:

“Procedurat e vlerësimit të konformitetit, sipas kategorive të rrezikut, të parashikuara në shtojcën I, janë si më poshtë: a) Kategoria I: kontrolli i brendshëm i prodhimit (moduli A), sipas shtojcës IV bashkëlidhur këtij rregulli; Në përmbushje të këtij kritri, operatori ekonomik ankimues, ka dorëzuar për të gjitha produktet objekt prokurimi, Deklaratën e Konformitetit të prodhuesit “Kinglong Protective Products (HUBEI) Co., Ltd”, shoqëruar me certifikatën e cilësisë për produktet e prodhuara nga prodhuesi, të cilët vërtetojnë përputhshmërinë me kërkesave e Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuar, të cilat janë konfirmuar se pas ekzaminimit/testimit dhe certifikimit të shoqërisë (prodhuese), artikujt e prodhuar nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të mësipërm pika 2.3.8, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA ” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi.
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, sipas konstatimeve në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, sipas konstatimeve në këtë vendim.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK.

7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

